Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

i. *Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

ii. *Përfitimet e punonjësve*

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

iii. *Leja vjetore e paguar*

Shoqëria njih si detyrim shumë të pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2018 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

iv. *Pagesat e qirave operative*

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave në përpjesëtim me kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

v. *Pagesat e qirave financiare*

Pagesat e qirasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qirasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepricën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

k) Llogari të pagueshme të sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me kosto.

l) Aktive të mbajtura për shitje

Aktivet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje maten me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Një njësi ekonomike klasifikon një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje nëse vlera e tij kontabël (neto) do të rifitohet parimisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm. Nëse ky është rasti, aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të jetë i përshtatshëm për shitje të menjëhershme në kushtet e tij aktuale subjekt vetëm për kushtet që janë të përdorshme dhe të zakonshme për shitjet e aktiveve të tilla (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) dhe shitja e tij duhet të jetë me probabiliteti të lartë për t'u realizuar brenda një viti. Këtë vit Shoqëria ka klasifikuar aktive afatgjata të mbajtura për shitje pasi ka plane afatshkurtra për të shitur aktivin brenda 12 muajve.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m) Prona, ambjenti dhe pajisjet

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi përveç ndërtimeve në proces të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve.

Kur pjesë të një aktivi kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërinë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë të rëndësishëm) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme përfshirën në vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që përfitimet të ardhshme do të rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes së periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

Amortizimi

Amortizimi për ndërtesat dhe përmirësimet e infrastrukturës llogaritet duke përdorur metodën lineare në përputhjen me jetën e dobishme ekonomike të aktivit ndërsa amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerën e mbetur në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen.

Amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata materiale sipas jetëgjatësisë së dobishme të parashikuar për periudhën e mëparshme dhe aktuale paraqitet si më poshtë:

Kategoria	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Ndërtesa dhe përmirësime infrastrukture	5%	5%
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje dhe orendi	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe programe	25%	25%

Vlera e mbetur, nëse nuk është e parëndësishme, duhet të rishikohet çdo vit. Përmirësimet teknike kapitalizohen dhe zhvlerësohen përgjatë afatit më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

n) Aktivet aftatgjata jomateriale

Aktivët aftatgjata jomateriale që janë të blera nga shoqëria, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet akumuluar. Norma e amortizimit është 25% bazuar në vlerën e mbetur të aktivit.

Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve aftatgjata materiale

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga shoqëria apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të trupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

n) Aktivët aftat-gjata jomateriale (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

o) Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra.

(i) *Tatim fitimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

(ii) *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

(iii) *Detyrimet e shtyra tatimore*

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

p) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionare dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

q) Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiare (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

r) Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë në provigjonin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

s) Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare-Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 bashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Përveç kontabilitetit mbrojtës, kërkohet zbatimi retrospektiv, por nuk është i detyrueshëm të jepet informacion krahasues.

Për kontabilitetin mbrojtës, kërkohet në përgjithësi aplikim në mënyrë prospektive, me disa përjashtime të kufizuara. Shoqëria plotëson kriteret për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 dhe synon të shtyjë zbatimin e SNRF 9 deri në datën efektive të standardit e ri të kontratave të sigurimit (SNRF 17), që i takon periudhave vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021. Për rrjedhojë, Shoqëria do shtyjë aplikimin e këtij standardi deri me 1 janar 2021, kur aplikohet dhe SNRF 17.

(i) Klasifikimi dhe Matja

Shoqëria nuk pret ndikim të rëndësishëm nga zbatimi i kërkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen në pasqyrat e saj financiare. Ajo pret që të vazhdojë të përdorë matjen me kosto të amortizuar për të gjitha aktivet financiare të cilat aktualisht Shoqëria ka në pasqyrat e veta të pozicionit financiar. Të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritet të japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe/apo të interesit. Kështu, Shoqëria pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, Shoqëria do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të vijë në përfundim se të gjitha këto instrumente kanë përmbushur kriteret për matje me kosto të amortizuar sipas SNRF 9, duke marrë parasysh edhe hyrjen në fuqi të standardit të ri të kontratave të sigurimit.

(ii) Zhvlerësimi

SNRF 9 kërkon që Shoqëria të regjistrojë humbjet e pritshme të letrave me vlerë, kredive dhe të arkëtueshmeve të tjera, mbi një bazë 12-mujore ose gjatë tërë ekzistencës së saj. Shoqëria do të duhet të bëjë një analizë më të detajuar e cila merr në konsideratë të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të bazuara, duke përfshirë elementet largpamës për të përcaktuar shkallën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

(iii) Kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria beson se të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse ekzistuese të cilat janë aktualisht të përcaktuara si marrëdhënie mbrojtëse do të vazhdojnë të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Sikurse SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme se si një njësi ekonomike kontabilizon mbrojtjet efektive, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

SNRF 4 Kontratat e sigurimit – Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4

Ndryshimet e SNRF 4-ës hyjnë në fuqi për periudhat raportuese që fillojnë pas dates 1 janar 2018. Amendimet adresojnë shqetësimet që lidhen me implementimin e standardit të ri mbi instrumentat financiarë, SNRF 9-ën, përpara implementimit të standardit të ri për kontratat e sigurimit që Bordi është duke shqyrtuar dhe që do të zëvendësojë SNRF 4-ën. Këto amendime paraqesin dy opsione për shoqëritë që u lëshojnë kontrata sigurimi klientëve: përjashtimin e përkohshëm nga aplikimi i SNRF 9-ës dhe metodën e mbivendosjes.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

s) Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

Përfshirja e përkohshme e SNRF 9

Shoqëritë të cilat kanë predominancë në aktivitetin e tyre të sigurimit, kanë mundësinë të zgjedhin moszbatimin e SNRF 9-ës. Ky përfshirje i lejon keto shoqëri të vazhdojnë aplikimin e SNK 39-ës Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja, ndërkohë që shtyjnë aplikimin e SNRF 9-ës të paktën, deri në 1 janar 2021. Predominanca do duhet të vlerësohet fillimisht në periudhën raportuese që vjen menjëherë pas datës 1 prill 2016 dhe përpara datës së implementimit të SNRF 9-ës. Rivlerësimi i predominancës në periudha të mëposhme mund të kryhet vetëm në raste të rralla. Shoqëritë që aplikojnë përfshirjen e përkohshme do duhet të japin shënime shpjeguese të tjera në pasqyrat e tyre financiare.

Metoda e mbivendosjes

Metoda e mbivendosjes është një mundësi për shoqëritë që do adoptojnë SNRF 9 dhe lëshojnë kontrata sigurimi, të sistemojnë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për aktive financiare të lejueshme; të cilat efektivisht rezultojnë me aplikim të SNK 39-ës. Ky sistemim eliminon luhatjen në veprimet kontabël që lindin prej aplikimit të SNRF 9-ës përpara aplikimit të standardit të ri të kontratave të sigurimit. Sipas kësaj metode, një shoqëri lejohet të riklasifikojë vlerat ndërmjet zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe atyre të të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivet financiare të lejueshme. Shoqëria duhet të paraqesë si zë të veçantë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve vlerën që vjen nga aplikimi i metodës së mbivendosjes, ashtu si dhe një zë të veçantë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për të njëjtin sistemim. Përfshirja e përkohshme aplikohet fillimisht për periudhat raportuese që nisin prej datës 1 janar 2018.

Në zbatim të kërkesave të amendimeve të standardit SNRF 4, Shoqëria ka bërë vlerësimin e kushtit të predominancës më 31 dhjetor 2017 e cila kërkon që përqindja e detyrimeve që lidhen me aktivitetin sigurues të jetë mbi 90% të totalit të detyrimeve të Shoqërisë, ose mbi 80% të tyre me kusht që Shoqëria të mos marrë përsipër angazhime të tjera të rëndësishme që nuk lidhen me aktivitetin sigurues. Bazuar në vlerësimin e kryer nga Shoqëria, detyrimet e lidhura me aktivitetin sigurues zënë 88% të totalit të detyrimeve (ku përfshihen llogarit e pagueshme të sigurimit dhe risigurimit, detyrimet për humbjen dhe rregullimin e shpenzimeve për humbjen, dhe rezervën e primit të pafituar), dhe kushti i predominancës plotësohet, me kushtin që Shoqëria nuk do të marrë përsipër angazhime të tjera të rëndësishme që nuk lidhen me aktivitetin sigurues. Rrjedhimisht, Shoqëria zgjedh të shtyjë afatin e aplikimit të SNRF 9-ës deri më 1 janar 2021, kur hyn në fuqi edhe standardi SNRF 17, dhe gjatë kësaj kohe do vazhdojë të njohë instrumentet e veta financiare duke aplikuar standardin SNK 39.

t) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende nuk janë efektive, deri në datën e lëshimit së pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë nuk janë të diskutuara në detaje.

SNFR 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria vendosi të aplikojë metodën e thjeshtëzuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetet praktike të disponueshme për këtë kalim. Kompania aplikon IFRS 15 vetëm për kontratat që nuk ishin plotësuar deri më datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018). Duke qenë se kontratat e sigurimit nuk janë të përcaktuara nga SNRF 15, Shoqëria pret që ndikimi kryesor i standardit të ri të jetë në kontabilizimin e të ardhurave nga shërbimet administrative dhe të menaxhimit të investimeve. Per rrjedhojë, Shoqëria nuk ka ndikim në njohjen e të ardhurave në 31 dhjetor 2018.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

s) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma (vazhdim)

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në shoqëri:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

t) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma (vazhdim)

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nëfjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka vendosur zbatimin e standardit nga data e saj e adoptimit të detyrueshëm, data 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shifrave krahasuese. Shoqëria nuk pritet të ketë impakt të rëndësishëm në lidhje me SNRF 16.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17-Kontratat e Sigurimeve, një standard i ri kontabël gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e shënimeve shpjeguese. Pasi të jetë efektive, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 -Kontratat e Sigurimeve që është publikuar në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jete, joete, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) dhe llojet e subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë.

Do të zbatohen disa përjashtime nga fushëveprimi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model të kontabilitetit për kontratat e sigurimit që është më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit.

Në kundërshtim me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, të plotësuar nga qasja e ndryshueshme e tarifave për kontratat me karakteristika të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë që janë kontrata thelbësisht të investuara në shërbime si dhe nga mënyra e alokimit të primit kryesisht për ato afatshkurtra, që zakonisht zbatohet neper kontratat e sigurimit të jo-jetës.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

t) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma (vazhdim)

Tiparet kryesore të modelit të ri të kontabilitetit për kontratat e sigurimit janë si më poshtë:

- Matja e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, që përfshijnë një rregullim eksplisit të rrezikut, do të rivlerësohet në çdo periudhë raportimi (flukset monetare të përmbushjes)
- Marzhin e Shërbimit Kontraktual (MSK) që është e barabartë dhe e kundërta me çdo fitim të "ditës së pare" në flukset e pritshme të realizimit të një grupi kontratash. MSK përfaqëson perfitueshmerinë e pafitur të kontratave të sigurimit dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së shërbimit (dmth gjatë periudhës së mbulimit)
- Disa ndryshime në vlerën e aktualizuar të flukseve të pritshme monetare të cilat rregullohen kundrejt MSK dhe në këtë mënyrë njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së mbetur të shërbimit kontraktual
- Efekti i ndryshimeve në normat e skontimit do të raportohet në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, të përcaktuara nga një zgjedhje e politikës kontabël
- Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve të shërbimeve të sigurimit në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse bazuar në konceptin e shërbimeve të ofruara gjatë periudhës
- Shumat që policë-mbajtësi gjithmonë do të marrë, pavarësisht nëse ndodh një ngjarje e siguar (komponentë jo të ndashëm të investimeve) nuk paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes, por njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e pozicionit financiar
- Rezultatet e shërbimeve të sigurimit (të ardhurat e fituara minus demet e pesuara) paraqiten të ndara ndaj të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimeve
- Shenime shpjeguese më të zgjeruara për të dhene informacion mbi shumat e njohura nga kontratat e sigurimit si dhe natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve që lindin nga këto kontrata.

SNRF 17 është efektiv për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me detyrim për paraqitje të shifrave krahasuese. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që Shoqeria të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17.

Aplikimi retrospektiv i këtij standardi është i nevojshëm. Megjithatë, nëse zbatimi i plotë retrospektiv për një grup kontratash siguri nuk është praktik, atëherë Shoqeria duhet të zgjedhë midis metodës së paraqitjes së modifikuar retrospektive ose metodës me vlerën e drejtë.

Shoqeria planifikon të miratojë standardin e ri në datën e kërkuar në fuqi së bashku me SNRF 9 (shih më lart). Shoqeria nuk ka nisur ende të vlerësojë ndikimin prej implementimit të SNRF 17. Shoqeria pret që standardi i ri do të rezultojë në ndryshime të rëndësishme në politikat kontabël për detyrimet e kontratave të sigurimit dhe ka gjasa të ketë një ndikim të rëndësishëm në rezultatin dhe kapitalin e Shoqerisë së bashku me prezantimin dhe shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Albsig sh.a

(Vlerat janë në Lek)

4. AKTIVE AFAT-GJATA MATERIALE

Aktivitet afat-gjata materiale më datë 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë paraqitur si më poshtë:

	Ndërtesa	Mobiljeri dhe orendi	Kompiutera	Pajisje zyre	Mjete transporti	Parapagime për ndërtesa	Të tjera	Totali
Kosto								
Gjendja më 1 janar 2017	358,033,154	27,718,863	29,599,324	4,768,206	76,719,857	-	17,413,326	514,252,730
Shtesa	68,951,823	7,211,749	2,988,170	-	7,289,517	201,605,732	-	288,046,991
Pakësime	-	-	-	-	(10,554,189)	-	-	(10,554,189)
Dalje jashtë përdorimit	(270,000)	(2,210,284)	(5,467,688)	(496,406)	-	-	(810,517)	(9,254,895)
Transferim në aktive të mbajtura për shitje	(188,769,207)	-	-	-	-	-	-	(188,769,207)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	237,945,770	32,720,328	27,119,806	4,271,800	73,455,185	201,605,732	16,602,809	593,721,430
Shtesa	8,680,188	12,951,439	7,936,488	-	8,472,622	343,324,808	6,528,584	387,894,129
Pakësime	-	-	-	-	(2,534,184)	-	-	(2,534,184)
Dalje jashtë përdorimit	-	(181,583)	(125,898)	(5,000)	-	-	(71,817)	(384,298)
Transferime	522,930,540	-	-	-	-	(522,930,540)	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	769,556,498	45,490,184	34,930,396	4,266,800	79,393,623	22,000,000	23,059,576	978,697,077
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 1 janar 2017	67,548,664	16,744,889	22,117,072	3,867,274	25,341,487	-	10,617,203	146,236,590
Amortizimi i vitit	11,282,365	2,774,499	2,187,341	177,310	9,226,253	-	514,797	26,162,565
Pakësime	-	-	-	-	(5,488,418)	-	-	(5,488,418)
Dalje jashtë përdorimit	(112,225)	(1,972,047)	(4,986,481)	(437,038)	-	-	(737,280)	(8,245,070)
Transferim në aktive të mbajtura për shitje	(6,325,361)	-	-	-	-	-	-	(6,325,361)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	72,393,443	17,547,341	19,317,932	3,607,547	29,079,323	-	10,394,720	152,340,306
Amortizimi i vitit	11,866,962	4,260,101	3,004,179	132,408	7,660,960	-	528,141	27,452,751
Pakësime	-	-	-	-	(1,570,687)	-	-	(1,570,687)
Dalje jashtë përdorimit	-	(163,657)	(114,608)	(3,434)	-	-	(66,343)	(348,042)
Transferim në aktive të mbajtura për shitje	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	84,260,405	21,643,785	22,207,503	3,736,521	35,169,596	-	10,856,518	177,874,328
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	165,552,327	15,172,987	7,801,874	664,253	44,375,862	201,605,732	6,208,089	441,381,124
Gjendja më 31 dhjetor 2018	685,296,093	23,846,399	12,722,893	530,279	44,224,027	22,000,000	12,203,058	800,822,749

Në 31 dhjetor 2018 dhe 2017, Shogëria nuk ka barrë mbi pronat, objektet dhe pajisjet. Në 2017 dhe 2018 Shogëria ka investuar në blerjen e dy ambienteve të reja në Rrugën e Barrikadave në Tiranë, në të cilat janë akomoduar zyrat e selisë qendrore të Shogërisë.

5. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë programe kompjuterike të cilat janë detajuar si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Total
Kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	18,115,116	18,115,116
Shtesat	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	18,115,116	18,115,116
Shtesat	24,866	24,866
Gjendja më 31 dhjetor 2018	18,139,982	18,139,982
Zhvleresim i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2017	12,063,222	12,063,222
Amortizimi i vitit	1,468,341	1,468,341
Gjendja më 31 dhjetor 2017	13,531,563	13,531,563
Shpenzimi i vitit	1,101,256	1,101,256
Gjendja më 31 dhjetor 2018	14,632,819	14,632,819
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,583,553	4,583,553
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,507,163	3,507,163

6. INVESTIME

Investimet me bankat dhe institucionet financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozita Bankare	913,429,087	978,668,292
Fondi Garancisë	385,850,525	390,960,781
Obligacion	8,000,000	8,000,000
Interes i përllogaritur	12,578,074	8,119,648
	1,319,857,686	1,385,748,721

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme. Depozitat me bankat përfshijnë depozita bankare të tjera me maturitet më shumë se 12 muaj.

Në 1 mars 2017 Shoqëria ka investuar në obligacione të emetuara nga NOA sh.a, një institucion financiar mikro-finance, me vlerë totale Lek 8,000,000 me një afat 3-vjeçar dhe normë interesi 7% në vit nën kujdestarinë e Banka Credins sh.a

Në përputhje me Nenin 81 të Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", fondi i garancisë nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e kufirit minimal të aftësisë paguese por jo më pak se 370 milion Lek, në bono thesari dhe depozita me afat me maturimi jo më të vogël se 1 vit. Më 31 dhjetor 2018, fondi i garancie së shoqërisë është mbi nivelin minimal të kërkuar sipas rregullatorit.

	interest %	31 dhjetor 2018	interest %	31 dhjetor 2017
Në Euro	0.01-1.30	373,668,176	0.01-1.50	680,965,482
Në Lekë	0.25-3.50	816,339,027	0.60-2.50	596,436,629
Në USD	0.20-1.30	109,272,409	0.80-1.30	92,226,962
		1,299,279,612		1,369,629,073

6. INVESTIME (VAZHDIM)

Depozitat me bankat dhe fondet e garancisë janë detajuar në monedhat si mëposhtë:

Detajimi i depozitave me afat sipas bankave është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Banka Credins	188,769,063	542,055,000
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	129,617,178	125,295,000
Banka Intesa SanPaolo	369,272,920	203,230,494
Banka Amerikane e Investimeve	94,958,612	175,963,619
ProCredit Bank	10,782,000	83,109,999
Banka e Tiranës	80,959,100	81,959,750
Banka Kombëtare Tregtare	73,665,078	53,969,000
Banka Tregtare Ndërkombtare	43,844,955	46,532,500
Banka e Parë e Investimeve	5,179,646	45,013,711
Banka Societe Generale	12,500,000	12,500,000
Union Bank	270,000,000	-
Bank Raiffeisen	19,731,060	-
	1,299,279,612	1,369,629,073

7. AKTIVE TË LIDHURA ME RISIGURIMIN

Rezerva e risigurimit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Rezerva për prime	36,906,454	90,766,758
Rezerva për dëme	96,020,760	26,590,000
	132,927,214	117,356,758

Rezerva e risiguruesit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 e ndarë sipas llojit të risigurimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Prona	32,258,851	77,055,327
Motorike	91,083,960	26,645,295
Aviacion	9,584,403	13,656,136
	132,927,214	117,356,758

Lëvizjet në rezervën e primit të pafituruar gjatë vitit 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar	90,766,758	38,405,623
Primet e shkruara gjatë vitit	137,700,501	90,766,758
Primet e fituara gjatë vitit	(191,560,805)	(38,405,623)
	36,906,454	90,766,758

Lëvizjet në rezervën e demeve për risigurimin gjatë vitit 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar	26,590,000	-
Dëmet e ndodhura nga risiguruesi	75,545,213	26,590,000
Dëmet e paguara nga risiguruesi	(6,114,453)	-
Më 31 dhjetor	96,020,760	26,590,000

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SIGURIMIT

Llogarite e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme nga klientët, neto	160,040,612	128,966,528
Të arkëtueshme nga agjentët, neto	3,320,322	5,050,290
	<u>163,360,934</u>	<u>134,016,818</u>

Detyrimet nga klientët neto më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime nga klientët, bruto	199,209,056	159,043,337
Minus zhvlerësimi i akumuluar	(39,168,444)	(30,076,809)
Detyrime nga klientët, neto	<u>160,040,612</u>	<u>128,966,528</u>

Levizjet në zhvlerësimin e llogarive të sigurimit të arkëtueshme nga klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shuma në fillim të vitit	30,076,809	25,511,247
Shtesa në zhvlerësim gjatë periudhës	9,091,635	4,565,562
Balance në fund të vitit	<u>39,168,444</u>	<u>30,076,809</u>

Detyrimet nga agjentët më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime nga agjentët, bruto	16,945,772	18,675,740
Minus zhvlerësimin	(13,625,450)	(13,625,450)
Detyrime nga agjentët, neto	<u>3,320,322</u>	<u>5,050,290</u>

Levizjet në zhvlerësimin e llogarive të sigurimit të arkëtueshme nga agjentët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shuma në fillim të vitit	13,625,450	13,056,423
Zhvlerësimin gjatë vitit	-	569,027
Shuma në fund të vitit	<u>13,625,450</u>	<u>13,625,450</u>

Detyrime nga garancitë 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime nga garancitë bruto	147,228,000	-
Minus zhvlerësimin	(147,228,000)	-
Detyrime nga garancitë, neto	<u>-</u>	<u>-</u>

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SIGURIMIT (VAZHDIM)

Levizjet në zhvlerësimin e llogarive të sigurimit të arkëtueshme nga garancitë detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shuma në fillim të vitit	-	-
Zhvlerësimin gjatë vitit	(147,228,000)	-
Shuma në fund të vitit	(147,228,000)	-

9. AKTIVE TË TJERA

Aktivitet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Garanci për Karonin Jeshil	39,457,374	42,504,114
Paradhënie personeli dhe agjent	1,613,199	4,197,941
Padi regresi	2,057,633	2,057,633
Inventari i policave	1,962,358	1,628,371
Aktive të tjera	15,030,117	11,496,242
	60,120,681	61,884,301

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA

Të arkëtueshme nga palët e lidhura deri më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga aksionarët	49,029,927	46,867,822
Të arkëtueshme nga kompanitë e lidhura	162,815,122	65,289,626
	211,845,049	112,157,448

11. MJETE MONETARE NË ARKË DHE NË BANKË

Mjete monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Para në bankë dhe në monedhë të huaj	18,275,269	26,034,201
Para në bankë dhe Lekë	19,254,087	20,684,362
Para në arkë	5,443,294	9,332,969
	42,972,650	56,051,532

Paraja në bankë përfshin llogari rrjedhëse. Mjetet monetare dhe ekuivalentet sipas monedhës origjinale janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EURO	21,176,377	28,647,833
LEKË	19,319,267	21,142,359
USD	2,477,006	6,261,340
	42,972,650	56,051,532

12. AKTIVE TË MBAJTURA PËR SHITJE

Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria vendosi që të shesë një ndërtesë dhe si rrjedhojë e paraqet si aktiv për shitje në vlerën 182,443 mijë Lek. Shoqëria nuk ka nënshkruar ende një kontratat megjithatë transaksioni i aktivitetit të mbajtura për shitje pritet të përfundojë në 2019.

13. AKSIONE NË SHOQËRI TË LIDHURA

Në vitin 2007 Shoqëria ka themeluar degën e Maqedonisë. Në datën 7 gusht 2017, Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë miratoi transformimin e borxhit të varur në vlerën 750,000 Euro (ekuivalente 100,275 mijë Lek) më qëllim rritjen e kapitalit të Shoqërisë Albsig AD Shkup (Maqedoni).

Më datë 21 nëntor 2017, Shoqëria mëmë shiti 90% të aksioneve të filialit me një cmim shitje prej 3,000,000 Euro (ekuivalente 399,069 mijë Lek) tek "XH&XH Teknologjia" shpk me bazë në Shkup (Republika Maqedonse). Nga shitja e aksioneve Shoqëria ka pësuar një humbje prej Lek 91,715 mijë Lek. Me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, Albsig sha zoteron 10% në shumën 43,093 mijë Lek, duke humbur kontrollin mbi filialin të quajtur tashmë "NOVA Insurance AD Skopje".

14. KAPITALI I AKSIONAR

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 879,460 mijë Lekë (më 31 dhjetor 2017: 879,460 mijë Lek) përberë nga 879,460 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lekë.

Struktura e kapitalit aksionar të shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	në %	Numri i aksioneve	në %	Numri i aksioneve
Shefqet Kastrati	84.00	738,745	84.00	738,745
Lokol Xhaja	10.00	87,946	10.00	87,946
Frida Mucmataj	4.00	35,179	4.00	35,179
Natasha Dhoqina	2.00	17,590	2.00	17,590
	100.00	879,460	100.00	879,460

15. REZERVA TEKNIKE PËR DËMET

Lëvizjet në rezerva teknike për dëmet më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbehet si më poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar	514,567,431	354,794,627
Dëmet e ndodhura	730,692,730	523,520,627
Dëmet e paguara	(681,813,951)	(363,747,823)
Më 31 dhjetor	563,446,210	514,567,431

Rezerva teknike të detajuara sipas produkteve më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbehet si më poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
RBNS	254,915,823	219,310,638
IBNR	297,482,422	285,167,252
Kosto për trajtimin e dëmeve	11,047,965	10,089,541
	563,446,210	514,567,431

15. REZERVA TEKNIKE PËR DËMET (VAZHDIM)

Rezerva teknike RBNS per dëmet është e detajuar per secilen linje biznesi si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	233,682,307	208,180,240
Prona	10,719,836	5,180,536
Shëndet	10,513,680	5,949,862
	254,915,823	219,310,638

Rezerva teknike IBNR per dëmet është e detajuar per secilen linje biznesi si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	287,478,822	275,751,579
Prona	4,826,073	2,537,691
Shëndet	5,177,527	6,877,982
	297,482,422	285,167,252

Rezerva e dëmeve e njohur për çdo kategori produkti është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	521,161,129	483,931,818
Prona	15,545,909	7,718,227
Shëndet	15,691,207	12,827,845
Shpenzime për trajtim dëmsh	11,047,965	10,089,541
	563,446,210	514,567,431

Dëmet e siguruara të paguara për çdo kategori produkti janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	390,440,452	280,973,493
Prona	208,128,171	60,609,019
Shëndet	75,777,964	22,165,311
Shpenzime për trajtim dëmsh	7,467,364	-
	681,813,951	363,747,823

Nga të cilat dëme te paguara nga risiguruesi

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	(6,114,453)	-
	(6,114,453)	-

16. REZERVA E PRIMIT TË PAFITUAR

Rezerva për primin e pafituar sipas produkteve përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Motorike	656,972,840	586,522,365
Prona	365,246,468	312,606,366
Shëndet	58,142,808	55,136,015
Të tjera	16,631,207	23,771,329
	1,096,993,323	978,036,075

Lëvizjet në rezervën e primit të pafituar gjatë vitit 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Më 1 janar	978,036,075	859,178,999
Primet e shkruara gjatë vitit	2,338,161,273	1,953,109,277
Primet e fituara gjatë vitit	(2,219,204,025)	(1,834,252,201)
Më 31 dhjetor	1,096,993,323	978,036,075

17. TË PAGUESHME NDAJ RISIGURUESIT

Të pagueshme ndaj risiguruesit paraqesin të gjithë rastete e papaguara nga Shoqëria për kontratat risiguruese në fuqi. Gjendja e llogarive të pagueshme është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Karton Jeshil	2,306,807	9,807,617
